


Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 24 paragrafi 11 dhe 12 të Rregullorës së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 07.04.2014, nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me Nr. AKK-03-1125/14, nën dyshimin për konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik për ztr. Sokol Krasniqi – Këshilltar në Asamblenë komunale në Prishtinë për shkak se; nuk ka konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik.

Por, zyrtari Krasniqi mund të gjendet në situatë të konfliktit të interesit “rast për rast”. Në raste të tilla, sipas ligjit, ztr.Krasniqi obligohet ta deklaroj ate dhe të tërhiqet nga vendimarrja.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti nr. AKK-03-1125/14, i hapur nën dyshimin për Konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik për ztr.Sokol Krasniqi-Këshilltar në Asamblenë komunale në Prishtinë, është trajtuar sipas procedurës së paraparë ligjore, për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik (Ligji Nr. 04/L-051).

Rasti është hetuar për mundësinë e paraqitjes së konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, dhe fillimisht zyrtarit të lartë ztr.Krasniqi i kemi bërë shkresën e parë njoftuese (Z-D-Dpk-01-1149/14) pas së cilës ai është paraqitur në takim me zyrtarët e Agjencisë kundër Korrupsionit.

Gjatë trajtimit të kësaj lënde, konform ligjit për Parandalimin e konflikti të interesit në ushtrimin e funksionit publik (Ligji për P.K.I., Nr.04/L-051), duke u bazuar në nenin 10, paragrafi 2 i Ligjit për P.K.I. është konstatuar se, nuk ka konflikt interesi siç është pretenduar nga parashtuesit e rastit, në lidhje me të qenurit e tij Këshilltar në Asamblenë komunale të Prishtinës dhe njëkohësisht Drejtor i klubit futbollistik Prishtina.

Neni 10, rregullon ushtrimin e veprimtarive tjera nga zyrtari i lartë krahas funksionit publik, ndërsa paragrafi 2 shprehimisht thotë:

“Gjatë kohës së ushtrimit të funksionit publik, zyrtari i lartë mund të ushtroj punë nga lëmi i shkencës, sportit, arsimit, kulturës dhe veprimtarisë tjetër humanitare, nëse nuk parashihet ndryshe me ligje tjera”.

Në fakt, te rasti konkret i ztr. Krasniqi, gjatë ushtrimit të funksionit të tij publik – Këshilltar në Asamblenë komunale të Prishtinës mund të ketë konflikt interesi “rast për rast”, por, për të parandaluar këtë situatë të shfaqjes së këtij lloji të konflikti të interesit, zyrtari i lartë është këshilluar nga zyrtarët e Agjencisë, e po ashtu edhe vet ka deklaruar se; i ka të kjarta veprimet të cilat duhet t’i marr në situata të tilla.

Ato veprime janë të përcaktuara me ligj dhe dalin nga neni 13 i Ligjit për parandalimin e konflikti të interesit, paragrafet 1, 2 dhe 3, që shprehimisht thonë:

1. Çdo zyrtar i lartë gjatë ushtrimit të funksionit të tij publike, në bazë të njohurive të tij dhe në mirëbesim, detyrohet që të bëjë vet deklarimin paraprak, rast për rast, të ekzistencës së interesit të tij private lidhur me vendimmarrjen në një çështje të caktuar, që mund të bëhen shkak për lindjen e një konflikti të interesit.

2. Deklarimi rast për rast i interesave private bëhet çdo herë nga zyrtari i lartë, kur kjo kërkohet nga eprori ose nga institucioni mbikëqyrës. Deklarimi si rregull duhet kërkuar dhe bërë paraprakisht. Kur kjo nuk është e mundur ose kur nuk ka ndodhur, deklarimi duhet të kërkohet të bëhet sa me shpejt që të jetë e mundur.

3. Vetë deklarimi si rregull bëhet me shkrim, kur zyrtari i lartë përfshihet në një vendimarrje për ndonjë çështje të caktuar.

II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK-së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./znj. (zyrtari ndihmës)

Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

